



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 535 Prot.  
2024

Tiranë, më 03 . 04 .

**V E N D I M**

**Nr. 89, Datë 03 . 04 . 2024**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën nr. 241 Regj., datë 08.11.2023, të z. A. Xh kundër Bashkisë Gramsh<sup>3</sup>, me pretendimin e diskriminimit për “çdo shkak tjetër<sup>4</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, z. A. Xh në ankesën e parashtruar pranë Komisionerit shprehet se:  
*“Kam qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Gramsh, që nga data 27.03.2017, e deri më datë 13.09.2023, kur në mënyrë të menjëhershme dhe të njëanshme më është zgjidhur kontrata e punës nga punëdhënësi.*

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

<sup>3</sup> Në vijim referuar edhe si Bashkia.

<sup>4</sup> Subjekti ankues ka shpjeguar se në këtë shkak ka klasifikuar ankimin për diskriminim, paraqitur prej tij pranë KMD-së, me ankesën me nr.155 regj., datë 08.08.2023.

Me datë 08.08.2023 jam ankuar tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kundër Bashkisë, në kuadër të një ankese tjetër, në objekt të së cilës kam pretenduar për veprime të padrejta e diskriminuese të punëdhënësit, lidhur me:

- Vendimin nr. 32, datë 19.06.2023 “Për dhënie mase disiplinore “Vërejtje me shkrim”, të Kryetarit të Bashkisë Gramsh;
- Vendimin nr. 131, datë 26.06.2023 “Për transferimin e punonjësit A. Xh”, të Kryetarit të Bashkisë Gramsh;
- Vendimin për mosdhënien e lejes vjetore të vitit 2023, sipas shkresës me nr. 2752 prot., datë 21.07.2023, të Kryetarit të Bashkisë Gramsh;
- Vendimin nr. 50, datë 26.07.2023 “Për dhënie mase disiplinore “Vërejtje paralajmëruese për largim nga puna”, të Kryetarit të Bashkisë Gramsh.

Ndërkaq, gjatë periudhës që ankesa ime ishte në shqyrtim pranë Komisionerit, me datë 13.09.2023, më është komunikuar Vendimi nr. 66, datë 13.09.2023 “Për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”, me motivacionin se: “Punonjësit A. Xh me detyrën “Punëtor”, në Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike, me dy masa disiplinore në fuqi, për shkak të mungesës së pajustificuar në punë në mënyrë të përsëritur, si dhe për moszbatim të përsëritur të urdhrave dhe punëve të ngarkuara nga eprori direkt, rrethana të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve të punës, t’i zgjidhet në mënyrë të menjëhershme kontrata e punës për shkaqe të justifikuara me Bashkinë Gramsh dhe të lirohet menjëherë nga kjo detyrë.”

Ankuesi ka pretenduar se motivacioni mbi të cilin është bazuar largimi i tij nga detyra nuk qëndron, dhe se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nga Bashkia ka ardhur si hakmarrje ndaj tij, për shkak të ankimit për diskriminim pranë KMD-së. (Ankesa me nr. 155 regj., datë 08.08.2023)

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës së tij të konstatojë diskriminimin nga ana e Bashkisë Gramsh.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon

*ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankuesit për diskriminim lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga ana e Bashkisë Gramsh.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1243/1 prot., datë 15.11.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime dhe dokumentacion provues Bashkisë Gramsh, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
2. Në vijim të shkresës së mësipërme, me shkresën me nr. 4596/1 prot., datë 24.11.2023, Bashkia Gramsh depozitoi pranë KMD-së parashtrimet e saj, duke cituar ndër të tjera, se:

*“Nga ana e Bashkisë Gramsh është ndjekur një procedurë e rregullt duke respektuar dispozitat e Kodit të Punës.*

*Z. A. Xh është emëruar pranë Bashkisë Gramsh në pozicionin “Punëtor”, nëpërmjet vendimit nr. 52, datë 23.03.2017, të Kryetarit të Bashkisë dhe efektet e punës i kanë filluar me datë 27.03.2017. Me vendimin nr. 23, datë 12.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi A. Xh nga pozicioni “Punëtor” është transferuar në pozicionin “Shofer administrate” në Drejtorinë e Shërbime Publike, pranë Bashkisë.*

*Në datën 08.06.2023, është ngritur Urdhri me nr. 107, “Për parkimin e automjeteve në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë brenda rrethimit të impiantit të përpunimit të ujërave të ndotura të Bashkisë”, të Kryetarit të Bashkisë Gramsh, ku për ndjekjen e zbatimit të tij janë ngarkuar Drejtoria e Infrastrukturës Rrugore, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Komunale, si dhe shoferët.*

*Ky urdhër është vazhdimësi e Urdhrit nr. 138, datë 01.06.2021, “Për parkimin e automjeteve në pronësi dhe përdorim të Bashkisë brenda rrethimit të impiantit të përpunimit të ujërave të ndotura të Bashkisë”, të Kryetarit të Bashkisë Gramsh, dhe në këtë urdhër shprehimisht thuhet se, çdo drejtues mjete që ka në përdorim mjetet e Bashkisë duhet të parkojë automjetet brenda rrethimit.*

Personi i ngarkuar nga Kryetari i Bashkisë për të verifikuar zbatueshmërinë e urdhrit është Drejtori i kabinetit z. Xh. B, i cili çdo ditë ka kryer verifikimet përkatëse dhe ka raportuar tek Kryetari i Bashkisë me anë të procesverbalëve të mbajtur në vendin e parkimit të automjeteve, përkatësisht:

- Procesverbali nr. 1, datë 12.06.2023;
- Procesverbali nr. 2, datë 13.06.2023;
- Procesverbali nr. 3, datë 14.06.2023;

“Për verifikimin e parkimit të automjeteve në pronësi/përdorim të Bashkisë brenda rrethimit të impiantit të përpunimit të ujërave të ndotura, në zbatim të Urdhrit nr. 107, datë 08.06.2023”, të mbajtur në prezencë të Drejtorit të Kabineteit, z. Xh. B, Përgjegjësit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. J. M, si dhe z. D. Sh, punëtor i KUZ (Roje), pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Komunale.

Në të tria ditët që është mbajtur procesverbali rezulton se nga ana e z. A. Xh nuk janë parkuar automjetet që ka patur në përdorim, në vendin e caktuar nga Bashkia për parkimin e tyre, dhe për rrjedhojë urdhri i Kryetarit të Bashkisë nuk është zbatuar nga punonjësi në fjalë.

Në vijim të punës, Kryetari i Bashkisë, në datën 09.06.2023 ka nxjerrë shkresën me nr. 2056 prot., me lëndë: “Mbi administrimin e kartave elektronike të karburantit”, ku përcaktohet se, çdo drejtori brenda datës 12.06.2023 duhet të dorëzojë me procesverbal kartat e karburantit që ka në administrim, si dhe të shënohet gjendja e sasisë së karburantit në momentin e dorëzimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Pranë zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, janë dorëzuar të gjitha kartat e karburantit, nga ku, vetëm z. Xh nuk i ka dorëzuar kartat e karburantit brenda datës së përcaktuar në shkresë për të cilin nuk rezulton të ketë procesverbal dorëzimi, pasi nuk i ka dorëzuar në zyrat përkatëse.

Pra, sa më sipër, punonjësi A. Xh nuk ka zbatuar as urdhrin dhe as shkresën e Kryetarit, moszbatimi i të cilave ka sjellë si pasojë marrjen e masës disiplinore kundrejt tij “Vërejtje me shkrim.”

Me ndryshimin e strukturës, me Vendimin nr. 36, datë 23.06.2023, “Për një ndryshim të Vendimit nr. 15, datë 18.02.2022 “Për një ndryshim të Vendimit nr.15, datë 18.02.2022 “Për miratimin e strukturës organizative për Bashkinë Gramsh dhe njësisive vartëse të saj, për vitin 2022”, të Kryetarit të Bashkisë, është shkurtuar pozicioni “Shofer administrate”, për shkak të mos ngarkesës së plotë në punë të dy shoferëve dhe është shtuar pozicioni “Punëtor”, në të njëjtën drejtori, për shkak të nevojës për punëtorë.

Aktualisht z. Xh është transferuar në pozicionin “Punëtor”, kjo për shkak të masës disiplinore në fuqi dhe moszbatimit të urdhrave të Kryetarit të Bashkisë.

Arsyeja e transferimit të z. Xh është për shkak të shkurtimit të vendit të punës dhe masës disiplinore në fuqi, fakte të cilat nuk kanë të bëjnë me diskriminimin në formën e shoqërimit, për shkak të bindjeve politike të vajzës së tij, sikurse pretendon z. Xh.

*Punonjësi për 4 ditë radhazi nuk ka qenë prezent në punë dhe për këtë arsye ka vijuar procedura disiplinore, e cila ka konkluduar me Vendimin nr. 50, datë 26.07.2023 “Për dhënie mase disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, të Kryetarit të Bashkisë.*

*Bazuar në shkresën me nr. 3354 prot., datë 01.09.2023, me lëndë: “Propozim për largim nga puna”, të Drejtorit të Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike, në datë 04.09.2023 është njoftuar për shkresën me nr. 3411 prot., datë 04.09.2023, me lëndë: “Njoftim për fillimin e procedurave për përfundimin e marrëdhënieve të punës”, të Kryetarit të Bashkisë.*

*Referuar procesverbalit me nr. 3455 prot., datë 07.09.2023, është mbajtur takimi mes ankuesit dhe përfaqësuesve të punëdhënësit, ku z. Xh gjatë mbledhjes është shprehur se nuk jap asnjë shpjegim para jush, pasi dua të jetë prezent Kryetari i Bashkisë dhe është larguar nga mbledhja.*

*Bashkia Gramsh për shkak të shkeljes së disiplinës në punë në mënyrë të përsëritur, duke humbur besimin e punëdhënësit, ka dalë me vendimin nr. 66, datë 13.09.2023 “Për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës me punonjësin A. Xh”, të Kryetarit të Bashkisë.”*

Bashkëlidhur parashtrimeve Bashkia ka dërguar edhe një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

3. Për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 175 prot., datë 30.01.2024, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore me datë 08.02.2024.

➤ Nga ana e Bashkisë, u kërkua të depozitohet gjatë seancës, si më poshtë citohet:

- Kopje e Rregullores së Brendshme të Bashkisë.
- Kopje e procedurës së ndjekur lidhur me shqyrtimin e pretendimit të ankuesit për diskriminim, nëse ka një të tillë.
- Parashtrime lidhur me largimin e ankuesit nga puna, gjatë periudhës kohore që ankesa e tij për diskriminim lidhur me masat disiplinore të dhëna kundrejt tij nga ana e Bashkisë, po shqyrtohej pranë KMD-së, në kuadër të ankesës me nr. 155 regj., datë 08.08.2023.
- Informacion lidhur me faktin nëse ankuesi e ka kundërshtuar gjyqësisht (deri aktualisht) largimin e tij nga puna. Nëse po, kopje të akteve provuese.
- Kopje të kontratës individuale të ankuesit në pozicionin “Punëtor” pranë Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike, Bashkia Gramsh, si dhe kopje të përshtimit të tij të punës.
- Kopje të raportit mjekësor të dorëzuar prej ankuesit tek punëdhënësi (07.09.2023-21.09.2023).

- Informacion nëse është ndjekur ndonjë procedurë verifikimi lidhur me raportin mjekësor të lëshuar për ankuesin në datat 07.09.2023-21.09.2023. Nëse po, kopje të akteve shkresore që provojnë procedurën e ndjekur.
- Kopje të akteve ku përcaktohen detyrat që i ishin ngarkuar ankuesit dhe nuk ishin përmbushur prej tij (për muajt qershor, korrik, gusht, shtator 2023).
- Kopje të relacioneve apo akteve të tjera shkresore, ku evidentohet puna e realizuar nga secili punonjës i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike, në pozicionin “Punëtor”.
- Informacion nëse ka patur masa të dhëna kundrejt ndonjë punonjësi tjetër të kësaj Drejtorie, në të njëjtin pozicion (punëtor) me ankuesin. Nëse po, kopje të procedurës së ndjekur për secilin rast.
- Si dhe çdo dokumentacion dhe shpjegime të tjera, që vlerësohet se ndihmojnë në sqarimin e rastit në shqyrtim.

4. Nëpërmjet e-mailit datë 06.02.2024, nga ana e Bashkisë Gramsh u kërkua që seanca të shtyhej për një datë tjetër, pasi për arsye të angazhimeve që kishte Bashkia, përfaqësuesit e saj, nuk mund të ishin të pranishëm në seancë.

5. Pas vlerësimit të sa më sipër, Komisioneri, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, me qëllim ballafaqimin e palëve dhe marrjen e informacionit të nevojshëm për trajtimin e ankesës, pranoi kërkesën e Bashkisë Gramsh dhe njoftoi palët<sup>5</sup> se seanca dëgjimore do të zhvillohet me datë 28.02.2024, pranë Zyrës së KMD-së.

6. Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 28.02.2023, ora 10:00, në ambientet e Zyrës së KMD-së, me praninë e subjektit ankues personalisht, dhe përfaqësueseve me autorizim të Bashkisë Gramsh<sup>6</sup>, M. K, me detyrë “Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore” dhe J. Ll, me detyrë “Specialiste e Burimeve Njerëzore”, pranë kësaj Bashkie.

Palët u qëndruan të njëjtave pretendime si ato të bëra të njohura shkresërisht në ankesën e parashtrimet e depozituara prej tyre para KMD-së.

7. Në vijim të seancës dëgjimore, palët dërguan dokumentacion shtesë<sup>7</sup>, i cili është depozituar në cilësi prove pranë KMD-së dhe është analizuar në harmoni dhe bashkarisht me provat e aktet e tjera të depozituara prej tyre gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga pala ankuese në këtë proces, Komisioneri vëren se, në analizë të kërkesë-padisë së ankuesit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga z. A. Xh për diskriminim në marrëdhëniet e punës, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

<sup>5</sup> Nëpërmjet e-mailit datë 09.02.2024.

<sup>6</sup> Autorizimi me nr. 930 prot., datë 27.02.2024, i Kryetarit të Bashkisë Gramsh.

<sup>7</sup> Parashtrime dhe akte bashkëlidhur shkruës me nr. 1183 prot., datë 12.03.2024, të Bashkisë Gramsh, si dhe dokumentacion dërguar nga ankuesi me e-mailin e datës 18.03.2024.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu i njëjti shkak që bëhet prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, është pretenduar dhe tek Komisioneri.

Në bazën ligjore të vendosur në kërkesë-padinë e depozituar pranë Gjykatës, regjistruar me datë 24.02.2024, ankuesi ka cituar shprehimisht: *“Nenet 18 e 49, të Kushtetutës së Shqipërisë, nenin 14, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nenet 31, 32/a, 106, 154, 154/a, e vijues të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile” i ndryshuar, nenet 4, 15, 17, 100, 107, 108, 109, 110, të Kodit të Procedurës Administrative, nenet 9, 21, 23, 130, 140, 143, 144, 145, 146, 147, 153, 155, të Kodit të Punës dhe ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.”*

Komisioneri konstaton se, në parashtrimet e kërkesë-padisë së bërë nga ankuesi pranë Gjykatës, ndër të tjera, respektivisht në faqen 3-24, të saj, citohet se:

*“... pas zgjedhjeve dhe fillimit punë të drejtuesit të ri të Bashkisë, ndaj punëmarrësit A. Xh kanë filluar veprimet dhe përpjekjet për ta larguar nga puna, veprime të cilat i vlerësojmë diskriminuese nga ana e punëdhënësit për shkak të kandidimit të vajzës së tij si anëtare e këshillit bashkiak për një subjekt politik.*

...

*... në kushtet kur është ndier i diskriminuar, paditësi i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që të hetonte bazuar në ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe të ndalonte veprimet diskriminuese të punëdhënësit.*

*Komisioneri në përfundim të shqyrtimit të ankesës, me Vendimin nr. 32, datë 05.02.2024, ka vendosur: “Konstatimin e diskriminimit, të ankuesit A. Xh, në të drejtën për punësim, në formën e shoqërimit, dhe në formën e shqetësimit, për shkak të bindjeve politike dhe kandidimit të vajzës së tij A. Xh<sup>8</sup> për anëtare e Këshillit Bashkiak Gramsh, nga ana e Bashkisë Gramsh.<sup>9</sup>”*

*Neni 9, i Kodit të Punës, parashikon se: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 2. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose*

---

<sup>8</sup> Kandidimit të saj për anëtare e Këshillit Bashkiak Gramsh, në zgjedhjet vendore 2023, si përfaqësuese e Partisë së Gjellbër.

<sup>9</sup> Ndërkohë, paditësi A. Xh ankohet për diskriminim edhe lidhur me momentin e zgjidhjes së marrëdhënieve të puëns nga ana e Bashkisë, fakt i cili ka ndodhur gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës së parë të z. Xh pranë KMD-së.

*të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.”*

Në faqet 6-11 të kërkesë-padisë citohet analiza e bërë në Vendimin nr. 32, datë 05.02.2024, të KMD-së, ku citohen shkeljet e LMD-së, nga ana e Bashkisë.

Nga faqja 14-19, e kërkesë-padisë së depozituar para Gjykatës, citohet ndër të tjera, se, veprimet e ndërmarra nga Bashkia kundrejt paditësit A. Xh, janë në kundërshtim flagrant me dispozitat e mëposhtme ligjore, ku garantohet mbrojtja nga diskriminimi, ndër të cilat citohen:

*“Kushtetuta e Shqipërisë, neni 18*

*“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.*

*2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.*

*3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.”*

*Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut<sup>10</sup> (KEDNJ), neni 14*

*“Ndalimi i diskriminimit”*

*“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindaj ose çdo status tjetër.”*

*Protokolli 12, KEDNJ, neni 1*

*“Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit”*

*“1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.*

*2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsytet e parashikuara në paragrafin 1.”*

*Kodi i Procedurës Administrative, neni 17*

*“Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit “*

*“1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë.*

*2. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë.*

*3. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë,*

---

<sup>10</sup> Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.



racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër.”

#### Kodi i Punës, neni 9

##### “Ndalimi i diskriminimit”

“1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohej çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

2. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përfashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

...

5. Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: ... c) kushtet e punës dhe punësimin, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar

#### Neni 1

##### Objekti

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

#### Neni 2

“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.”

### Neni 3

“1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1, të këtij ligji.

13. “Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtëruar a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.”

### Neni 5

#### Ndalimi i diskriminimit

“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.”

### Neni 7

#### Mbrojtja nga diskriminimi

“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”

### Neni 15

“1. Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit. 2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës. 3. Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit.

4. Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për aq kohë sa është e nevojshme për t'u mbrojtur nga diskriminimi. Punëmarrësi kthen pagën e marrë, sipas këtij neni, në rast se diskriminimi i pretenduar nuk rezulton i vërtetuar me vendim të formës së prerë.”

Në kërkesë-padinë e paraqitur, paditësi kërkon para Gjykatës, ndër të tjera, si vijon:

“Në bazë të nenit 146/1/c, të Kodit të Punës, ku përcaktohet se: “Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur: ... c) shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë Kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi...”, rezulton se zgjidhja e kontratës së punës në kushtet e diskriminimit konsiderohet se është për shkaqe të paarsyeshme dhe kërkojmë që të konstatohet si i tillë edhe nga ana e Gjykatës.”

Bazuar në sa më sipër, subjekti ankues, në kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës, ka pretenduar *inter alia*, trajtimin e padrejtë dhe diskriminues nga ana e Bashkisë Gramsh, lidhur me largimin e tij nga puna, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime dhe shkaqe që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së<sup>11</sup>.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkaku ligjor të padisë, citohet:

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërkimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njësuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njësuar të tij në rastet

---

<sup>11</sup>Komisioneri lidhur me pretendimet e ankuesit për trajtim diskriminues nga ana e Bashkisë, për periudhën kur ishte në marrëdhënie punë me të, i ka shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër, vendimmarrja e KMD-së, e cila është cituar edhe nga ankuesi para Gjykatës.

konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”*. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: *“Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”*.

Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se:

*“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se:

*“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën me nr. 241 Regj., datë 08.11.2023, të z. A. Xh, dhe deklaracionin pushimin e shqyrtimit të saj<sup>12</sup>.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

*“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka*

---

<sup>12</sup> Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021, nr. 27, datë 16.02.2021, nr. 77, datë 07.05.2021, nr. 230, datë 25.11.2021, nr. 253, datë 28.12.2021, nr. 77, datë 21.04.2022, nr. 108, date 20.06.2023, të Komisionerit.

rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë<sup>13</sup>, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 241 Regj., datë 08.11.2023, të paraqitur nga shtetasi A. Xh, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

---

<sup>13</sup> Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.